

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** *“Blerje foni pallati i kulturës”*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
**34993000-4**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**1.380.000** *(një milion e treqind e tetëdhjetë mijë ) lekë pa tvsh*

Llogaritja e fondit limit është bërë bazuar ne Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,kreu IX “Rolet dhe përgjegjësitë e autoritetit kontraktor ”,kreu X ,neni 76 ,pika 1 c “Mënyrat e përlllogaritjes se vlerës së prokurimit ”. Kjo vlere eshte llogaritur nga komisioni per llogaritjen e fondit limit te ngritur nga Titullari i AK me urdher nr.72 date 06.02.2024,duke u bazuar ne studimin e tregut dhe duke nxjerre mesataren e tre ofertave nga tre operatore ekonomike qe operojne ne kete fushe.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Maliq ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3...;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**  
Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2020,2021,2022 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

**Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

**2.2.2** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetet për vitin 2023 sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.**

\* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per proceduratatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga shpallja e njoftimit të kontratës, ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% i fondit limit të kesaj kontrate

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të garantojë me anë të një Vetedeklarimi se do dorëzojë mallin sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, brenda 30 ditëve nga data e kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

**Argumentim:** Në bazë të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 85, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri Autoriteti Kontraktor siguron se do të furnizohet me mallrat e kërkuar brenda afatit të kontratës.

## Specifikimet:

### 1- Mixer Dynacord 1600-3 Power

- Dynacord Kanalet dalëse 16
- Kanalet stereo 4
- Dalja RMS në Watt @ 4Ohm 2x1000
- Përpunimi i sinjalit analog
- Mixer i fuqizuar
- Procesori i integruar i efekteve
- Kanalet AUX 4
- EQs 3-Band
- Prerje e ulët
- Përshtatës i integruar i energjisë
- Hyrja USB
- Dalje USB
- Ndërfaqja e integruar audio
- EQ i mesëm parametrik
- Pesha (kg): 15

### 2- Boxe me vetëamplifikim 800 W 8 Ohm 15"

- Konfigurimi: 2 drejtime
- Përgjigja e frekuencës: 50hz - 18kHz
- Frekuenc të ulët të ndërthurura : 15" me 3" VC
- Drejtues me frekuencë të lartë: 1" me 1.7" VC
- Kont/maku maksimal i SPL: 128 / 132 dB
- Shpërndarja: 80 x 50 (HxV)
- impedanca e hyrjes: 8  $\Omega$
- Fole për bazën e altoparlantëve 35 mm (1,38") dhe dy doreza alumini
- Mbulesa me kompensatë thupër 15 mm (5/8"), bojë e zezë rezistente ndaj gërvishtjeve
- I përshtatshëm edhe për instalime të përhershme
- Dimensioi neto: 425 x 750 x 421 mm
- Pesha neto: 26 kg
- 4 copë x 10 m = 40 m kabëll, për lidhje microfona, në skaje, Zheg (fishë) -----  
Canon
- 2 copë x 4 m = 8 m kabëll, për lidhje microfona, në skaje, Zheg (fishë) -----  
Canon
- }

### 3- Boxe me vetëamplifikim monitor skene

- Monitor aktiv i përforcimit aktiv i përpunuar 130dB SPL.
- Dizajni me refleksi basi me 2 drejtime, dhe me dy përforcime.
- Amplifikatorë me dinamikë të lartë për të ofruar një tingull të këndshëm edhe me volum të lartë.

- Mbulesa të forta të derdhura nga polipropileni të injektuar me gaz për të shmangur rezonancën e padëshiruar.
- Veshje rezistente ndaj motit nën skarë për të mbrojtur drejtuesin dhe altoparlantin, SPL e lartë në një monitor me madhësi kompakte.
- Paneli i përparmë i anuar 35° ose 55° për një distancë optimale dëgjimi për përdorues të vetëm ose të shumëfishtë.
- Tre doreza mbajtëse të integruara ergonomike.
- Këmbët e zëvendësueshme me Teflon lejojnë një përdorim të lehtë në skenë.
- 2 copë x 10 m = 20 m kabëll, për lidhje bixe me mixer në skaje Speacon -----  
Speacon

#### 4- Microfon manualë

- Elementi dinamik
- Model polar kardioide
- Pesha 129 gram
- Të shoqërura me garanci.
- 4 copë x 10 m = 40 m kabëll, për lidhje microfona, në skaje, Zheg (fishë) -----  
Canon

#### 5- Microfon me Warles AKULLORE (2copë)

- Teknologjia e lidhjes Infra të kuqe
- Veçori e veçantë me valë, e rikarikueshme
- Transmetues dore me çantën dinamike superkardioid me zinxhir
- Modeli polar me një drejtim
- Ndjeshmëria e adios 120 dB
- Pesha e artikullit 126 g
- Dimensionet e artikullit LxËxH 11,02 x 5,28 x 3,15 in

#### I INSTALUAR NË KOKË (2 copë)

- Frekuencat e funksionimit: brezi i lartë VHF, 169 MHz deri në 172 MHz
- Modaliteti i modulimit: FM
- a- Sistemi Marrës:
  - Sistemi i antenave të dyfishta, me një kanal, pa diversitet
  - Përmasat: 190,0 mm G x 46,2 mm x 128,5 mm D
  - Pesha neto: 337 gram
  - Aksesorit i përfshirë: Furnizimi me energji elektrike
- b- Paketa e Transmetuesit :
  - Fuqia 10 mW
  - Dy Baterit AA 1.5V
  - Përmasat: 70,2 mm G x 103,7 mm H x 24,9 mm D

- Pesha neto: 80,0 gram
- c- Sistemi I mikrofonit
- Fuqia 10 mW
- Dy Baterit AA 1.5V
- Përmasat: 251.8 mm e gjatë,
- Diametri: 53,5 mm).
- Pesha neto: 260 gram

6- Stativa profesional për microfona, me tre këmbë

- Mbështetja e mbajtëses të mikrofonit me këmbë të palosshme
- Gama e lartësisë: 105 deri në 167 cm
- Zgjatja maksimale e krahut 55 cm
- Fije montimi 3/8" -
- Pesha: 2,6 kg
- Ngjyra: E zezë.

7- Stativa profesional për boxe, me tre këmbë

- Qëndrimet e altoparlantëve për punë të rënda
- Kapaciteti i peshës mbajtëse 36 kg.
- Përfshin mbajtësin e montimit të prizës për t'u lidhur me altoparlantin
- Lartësia maksimale e rekomanduar: 180 cm
- Diametri i tubit 35mm
- Pesha 3,75 kg

8- Stativa profesional për boxe, tubo

- Lartësia e rregullueshme 810 mm - 1340 mm
- Pesha 1.38 kg
- Materiali i tubit çeliku
- Diametri i tubit 35 mm
- Ngarkesa maksimale 35 kg
- Ngjyra e zezë